

Eppc Kosovo kërkon një **Menaxher të Divizionit të Shitjes me shumicë** për klientin e saj, i cili është një ndër kompanitë më të mëdha që operon në fushën e shitjeve të produkteve shëndetësore/farmaceutike.

Përgjegjësitë Kryesore:

- Menaxhimi i një numri agjentësh, që do të jenë në varësinë e tij;
- Ndjek porosinë në çdo hallkë deri në mbylljen e procesit të kontraktimit;
- Planifikimin dhe koordimin e shitjeve sipas modelit /strategjisë së kompanisë;
- Merr porositë tek klientët ekzistues, bën shpërndarjen e produkteve, dhe identifikon klient të rinj;
- Rregullon dhe organizon marrëdhëniet me pikat e shitjeve duke vizituar çdo pikë shitje sipas programit;
- Mban kontakte të vazhdueshme me klientët në lidhje me kërkesat e tyre;
- Koordinimi i porosive të klientëve në bazë të një vlerësimi logjik;
- Monitorimi i tregut në tërësi, mbledhja e informacionit dhe raportimi;
- Ndërton raportet dhe besueshmërinë me bizneset dhe vendimarrësit;
- Raportime periodike mbi rezultatet e shitjes.

Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Diplomë universitare;
- Eksperiencë të ngjashme së paku tre (3) vite në fushën e prezantimit, shpërndarjes dhe distribucionit (Eksperienca si B2B Sales përben avantazh);
- Të zotërojë shumë mirë paketën MS Office;
- Njohuri të mira në industrinë e produkteve shëndetësore;
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi, negocimi dhe shitjeje;
- Aftësi të mira organizative dhe të ofroj zgjidhje të shpejtë dhe me cilësi për klientët;
- Të jetë person energjik, i motivuar, fleksibil dhe i/e aftë të punojë me saktësi nën presion;
- Të posedojë leje drejtimi, kategoria B.

Të dhënat:

Pozicioni:	Menaxher i/e Divizionit të Shitjes me shumicë
Vendndodhja:	Prishtinë;
Pagesa:	Në nivel shumë të mirë;
Kontrata:	Sipas Ligjit të Punës;
Aplikimet mbyllen:	13.10.2017.

Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj dhe dokumentet e tjera shoqëruese duke **përmendur pozicionin për të cilin aplikoni** në adresën e e-mail^{it}:

kosovo@eppc.al

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj dhe dokumentet shoqëruese do të kualifikohen. Tek ne CV-ja juaj është e sigurt dhe trajtohet në konfidencialitet të plotë.